

VËSHTRIM RRETH PËRDORIMIT TË FJALË-TERMAVE NGA NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA NË VUSHTRRI

OVERVIEW OF STUDENTS' USE OF WORDS AND TERMS IN UPPER SECONDARY SCHOOLS IN VUSHTRRI

Albulena PLLANA-BREZNICA¹, Zana PLLANA²

^{1*} Technical High School „Lutfi Musiqi” Vushtrri, Republic of Kosovo

² Phdcand. University „Cyril and Methodius” Skopje, North Macedonia

^{*}Corresponding author e-mail: albulena.c@hotmail.com, zanapllana1@gmail.com

Abstrakt

In this paper, we will discuss the use of certain word-terms by students in upper secondary schools in Vushtrri, for which we will propose equivalents in the Albanian language. Many of these word-terms are derived from English. Through our research—by recording the anglicism's that appear in students' writing and spoken language—we have identified a large number of borrowings, particularly those referring to everyday concepts (especially among students), as well as terms related to technical and economic subjects.

Given the widespread use of information technology in high schools today, we will also include a considerable number of terms from this field of contemporary knowledge. The paper will present these word-terms, offering reflections (often thought-provoking) on their use and suggesting possible replacements from the general lexical treasury of the Albanian language.

Keywords: words-terms, anglicism's, equivalents in Albanian, students of upper secondary schools in Vushtrri.

Përmbledhje

Në këtë punim do të bëjmë fjalë për përdorimin e disa fjalë-termave nga nxënësit e shkollave të mesme të larta në Vushtrri, për të cilat do të propozojmë barasvlerësit në gjuhën shqipe. Kryesisht një numër i fjalë-termave janë të prejardhura nga gjuha angleze. Nga hulumtimi ynë, në anën tjetër, duke i regjistruar anglicizmat që paraqiten nëpër shkrime dhe në gjuhën e folur deri tani kemi hasur në një numër të madh të anglicizmave, kryesisht për fjalë-terma që emërtojnë gjëra të përditshme (kryesisht të nxënëset) dhe për disa lëndë mësimore të fushave teknike dhe për lëndë mësimore të ekonomisë.

Duke u nisur nga përdorimi i teknologjisë informative, në këtë shekull, nëpër shkolla të mesme të larta, gjithashtu do të japim edhe një numër të konsiderueshëm termash për këtë fushë dije të kohës. Do t'i prezantojmë fjalë-termat, duke u orvatur të japim ndonjë mendim (shpesh nxitës) për përdorimin, respektivisht, për zëvendësimin e tyre me fjalë nga thesari i përgjithshëm i gjuhës shqipe.

Fjalët kyçe: fjalë-terma, anglicizma, barasvlerësit në gjuhën shqipe, nxënësit e shkollave të mesme të larta në Vushtrri.

Hyrje

Detyra parësore, për të realizuar komunikim të suksesshëm gjuhësor, profesional e shkencor, në rrafshin mbarëkombëtar është jo vetëm i dëshirueshëm, por edhe e domosdoshme që pjesëmarrësit e aktit të komunikimit dhe ligjërimit të kenë njohuri të domosdoshme për realitetin objektiv që i rrethon në veprimtari të ndryshme arsimore e prodhuese në jetën e përditshme. Kur flasim, shkruajmë e ligjërojmë duhet të kemi parasysh shkallën e aftësive të atyre që i kemi përballë.

Qartësia, pra, është faktor vendimtar e i pazëvendësueshëm në procesin e përvetësimit të njohurive të ndërlikuara që i ndesh nxënësi, studenti, lexuesi në tekste shkollore e studime të ndryshme shkencore e profesionale. Kë duhet pasur parasysh sidomos profesorët që ligjërojnë nëpër shkolla të mesme profesionale, për shkak të zhvillimeve të vrullshme shkencore, mungesën e literaturës së kohës, si edhe johomogjenitetin e nxënësve e studentëve të cilët vijnë nga vende të ndryshme, me arsimim të ndryshëm.

Ligjëruesit e lëndë profesionale duhet të kenë kujdes gjatë përdorimit të huazimeve dhe kalkeve të pa nevojshme. Për këtë dukuri, kanë shkruar prof. Eqrem Çabej dhe prof. Androkli Kostallari, në kohën e tyre. E. Çabej ka shkruar: *“Sot ka gjer diku dy gjuhë ndër ne: me një anë, gjuha e shkruar e intelektualëve, në anën tjetër gjuha e thjeshtë e popullit”* (Çabej III, 1976:101-102).

Prof. Kostallari ka shkruar: *“Po rrudhet relativisht pesha specifike e fjalëve bazë të shqipes, që janë fjalët e burimit popullor dhe po krijohet njëfarë rreziku i largimit të papërligjur të gjuhës letrare kombëtare nga gjuha e folur e popullit”* (Kostallari, 1984:44). Prof. Kostallari jep rrugën e zgjidhjes së problemit: *“Njëra ndër rrugët themelore të zgjidhjes së këtij problemi është kufizimi i kalkimeve nga gjuhët e huaja, sepse pikërisht këto kalkime janë burimi kryesor i përpjesëtimeve jo të përligjura në mes fondit popullor e libror të shqipes së sotme letrare”* (Kostallari, 1984:45).

Drejtimit për arsimim në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” – Vushtrri (Viti shkollor 2025/26)

Shkolla e mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri ka një numër të konsiderueshëm të nxënësve, të cilët kanë zgjedhur këto drejtime: *makineri, prodhim ndërtimtari, zdrukthëtari – DUAL, operator i prodhimit, dirigjimi kompjuterik i makinave, automekanik – DUAL, instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit, trafik rrugor; drejtimi: Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit, zhvillues i aplikacioneve, teknik i informatikës së biznesit; drejtimi: Mekatronikë, mekatronikë; drejtimi: Energjetikë: instalues elektrik.*

Drejtimit për arsimim në shkollën e mesme profesionale “Bahri Haxha” – Vushtrri (Viti shkollor 2025/26)

Shkolla e mesme profesionale “Bahri Haxha” në Vushtrri ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm të nxënësve, të cilët kanë zgjedhur këto drejtime: *agrobiznes, hortikulturë, arkitekturë, marketing, kontabilist, tregtarë me pakicë dhe shumicë, përpunimi i metaleve, teknologji e riciklimit, laborant i kimisë, teknologji ushqimore, kuzhinier dhe konfeksion.*

Andaj është përgjegjësi e institucioneve shtetërore, sidomos e Mistrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Prishtinë, për të siguruar literaturë bashkëkohore, detyrë relativisht e vështirë, por shumë e nevojshme për krijimin e fjalë-termave të nevojshme sipas kërkesave të kohës, fjalorëve terminologjikë dhe manualeve më se të domosdoshëm për të zënë hapin me vendet e rajonit dhe të Europës, në fushat e dijes më bashkëkohore.

Formimi i fjalë-termave për terminologjinë tekniko-shkencore në gjuhën shqipe

Fjala *term* e ka burimin nga latinishtja *terminus*, që do të thotë *cak, kufi, skaj*. Tërësia e termave të një fushe dije të caktuar quhet *terminologji*, fjalë e krijuar gjithashtu nga latinishtja *terminus* dh greqishtja *logos* (dituri). Me termin *terminologji* kuptohet tërësia e termave të posaçëm që kanë zë vend dhe ata që do të krijohen) në një lëmë të shkencës a të teknikës. Me problemin e fjalës *term* merret sot edhe logjika edhe gjuhësia.

Për terminologjinë tekniko-shkencore në gjuhën shqipe, në parim duhet të mbështesim qëndrimin që si bazë për formimin e termave për çdo fushë dije të merren fjalët e njohura, të zakonshme nga thesari i gjuhës shqipe, duke shfrytëzuar fjalorët e gjuhës së sotme shqipe (1980, 2006), fjalorët terminologjikë (seria 1-15, të botuar nga viti 1963 në Tiranë), si edhe grumbullin e fjalorëve të botuar për shumë fusha të dijes deri në ditën e sotme, nga gjuhëtarët dhe specialistët shqiptarë. Është e vërtetë, se, një numër termash janë vjetruar, të shënuara në fjalorët e botuar deri në fillim të mileniumit të tretë, ku shumë terma kanë dalë nga përdorimi dhe duhet përditësuar fjalorët me terma të rinj, duke u bazuar në zhvillimet teknologjike të kohës, ku secili prodhues i pajisjeve dhe makinave përdorë terminologjinë e vendit të vet.

Për të zënë hapin, për krijimin e termave në gjuhën shqipe në këtë kohë, kërkohet një bashkëpunim i gjuhëtarëve dhe specialistëve të shumë fushave profesionale dhe shkencore. Për realizimin e këtij qëllimi të drejtë duhet t'u përmbahemi këtyre kriterëve të Sektorit të Terminologjisë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë:

- të shfrytëzohen mundësitë e mëdha që ka gjuha jonë për të krijuar fjalë-terma nga fjalët e përdorimit të përgjithshëm;
- të aktivizohen sa më shumë që të jetë e mundur tipat më prodhues të fjalëformimit të shqipes;
- të shqipërohen sa më shumë terma të gjuhëve të huaja të llojit ndërkombëtar.

Duke u nisur nga numri relativisht i madh i drejtimeve për arsimim në shkollat e mesme profesionale në Vushtrri, po japim nga disa fjalë-terma për disa drejtime, si: për **agrobiznes, hortikulturë**; *shampinjon* (fr. *champignon*) në vend *kërpudh/ë-a*; *ruptur/ë-a* në vend *këputj/e-a*; *radial board* në vend *dërrasë rrezore*; *markim druri* (engl. *marking of wood*) në vend *markëtim i drusë*; *kastrim-i* (engl. *castration*) në vend *tredhj/e-a*; *aderencë* (engl. *adherence*) në vend *ngjitshmëri-a*; *adhezion* (engl. *adhesion*) në vend *lidhshmëri* etj.

Termet nga anglishtja janë përfshirë dhe vijnë të përfshihen në literaturën shkollore, në një pjesë kryesore të fushave të dijes. Në vazhdim mund të përmendim disa terma nga fusha e **informatikës dhe projekimit (vizatimit) me kompjuterë**, si: CAD [angl. *Computer-Aided Design*] (angl.)- projektim me kompjuter (shq.), CAD [angl. *Computer-Aided Drafting*] (angl.)- skicim me kompjuter (shq.), CAD [angl. *Computer-Aided Drawing*]-vizatim me kompjuter (shq.), CAD/CAM [angl. *Computer-Aided Design/Computer-Aided Manufacturing*]-projektim-fabrikim me kompjuter (shq.), CAAD [angl. *Computer-Aided Design and Drfting*] (angl.)- projektim dhe skicim me kompjuter (shq.), CAE [angl. *Computer-Aided Engineering*] (angl.)- inxhinieringu me anë të kompjuterit (shq.), CAI [angl. *Computer-Aided Instruction*] (angl.)- arsimim me kompjuter (shq.), CAL [angl. *Computer-Aided Learning*](ngl.)-mësim me ndihmën e kompjuterit (shq.), *adapter-përshtatës* ose *adapter*, *accses* (angl.) – akses, *actuator* (angl.)- aktuator (meknizëm vepror), *alphageometric* (angl.)-alfageometrik, *alphamozaic* (angl.)- alfamozaik, *android-android* ose *sinjeri* [robot si njeriu], *background* (angl) - bekgraund (prapavijë, në plan të dytë), *back-up*(angl.) -bëj një kopje rezervë, *barcod-bar bar-code* (angl.) - barkod (kod me shoka), *bit(binary digit)* (angl.) -bit (shifër binare), *blank-blenk* zbrazët(i) [paplotesuar (i), bardhë (i)], *bold* (angl.) - bold [zeza (të) (shkronja)], *bus* (angl.) -bus ose magjistrale, *correct* (angl.) – [drejtë (i), saktë (i), rregullt (i)], *correspondencë* (angl.) – korrespondencë (letërkëmbim), *data* (angl.) – data (të dhëna), *data bank* (angl.) – databankë (bankë e të dhënave), *hacker* (angl.) – haker, *hard disk* (angl.) – harddisk (disk i ngurt, disk

fiks), *implement* (angl.) – *implement* (zbatoj, kryej; vë në jetë), *know-how* (angl.) – *knouhou* (shkathtësi, zotësi, aftësi, njohuri teknike), *master key* (angl.) *masterki* (çlës kryesor), *modem* [*Modulator-DEModulator*] (angl.) – *modem* (modulator – demodulator), *network* (angl.) – *netuork* (rrjet), *on-line processing* (angl.) – *onlaj procesing* (përpunim në linjë; përpunim i drejtpërdrejtë me kompjuter), *password* (angl.) – *pasuord* (fjalëkalim), *prefix* (angl.) – *prefiks* (aparshesë), *printer comand* (angl.) – *printerckomand* (urdhër shtypësi), *save* (angl.) – *sejv* (ruaj), *scaner* (angl.) – *skaner*, *software* (angl.) – *softuer* (programet e kompjuterit), *target program* (angl.) – *program objektiv, shënjestër; e synuar*, *traffic* (angl.) – *trafik* (qarkullim, komunikacion), *web* (angl.) – *ueb*, *Web address* (angl.) – *adresë në Ueb* (Duro, 2009:203) etj.

Si terma brenda një fushë dije mund të shërbejnë tekstet mësimore dhe në mënyrë veçantë fjalorët e fushës përkatëse të dijes. Në disa fusha të dijes, termat funksionojnë në disa gjendje, pra, jo vetëm si të vetëm, por edhe në bashkëvajtje me terma shqip, që përdoren si dysorë krahas tyre, kur njëri ndaj tjetrit zë në çift vendin parësor ose dytësor. Kur përdoren si të vetëm ata shfaqen si terma standard dhe si të tillë futen në gjuhë si njësi të huaja, por të domosdoshme, duke mos gjetur barasvlerës në gjuhën shqipe; p.sh. nga fusha e ekonomisë e marketingut mund të përmendim: fusha **ekonomisë dhe marketingut**, si: *businessperson* (angl.) – *afarist*, *arbitrage* (angl.) – *arbitrazh-i*, *audit* (angl.) – *audit* (rishqyrtim), *bank* (angl.) – *bank/ë-a, -at*, *creditor's bank* (angl.) – *bankë e kreditorit*, *credit bank* (angl.) – *bankë kreditimi*, *debt* (angl.) – *borxh/i, -et*; *check* (cheque) (angl.) – *çek-, çequet*; *debtor* (angl.) – *debitor-i, ët*; *debit* (angl.) – *debi-a*, *deflation* (angl.) – *deflacion-i*, *bank failure* (angl.) – *falimntim banke*, *financing* (angl.) – *financim-i*, *guarantee* (guaranty) (angl.) – *garanci-a, -të*, *guarantor* (angl.) – *garantues-i, -it*; *inflation* (angl.) – *inflacion-i*, *interest* (angl.) – *interes-i, at*; *base capital* (angl.) – *kapital bazë*, *commission* (angl.) – *komision-I, -wt*; *credit* (angl.) – *kredi-a, -të*; *account* (angl.) – *llogari-a, -të*; *margin* (angl.) – *marxh-i* (hap/ë-a), *broker* (angl.) – *ndërmjetës-i, -it*; *money* (angl.) – *para-ja, -të*; *refinancing* (angl.) – *rifinancim-I*, *basis risk* (angl.) – *risk-bazë*, *financial risk* (angl.) – *risk financiar*, *tariff* (rate; fee) (angl.) – *tarif/ë-a, -at*; *discount* (discounting) (angl.) – *zbritje* (Pasho, 2005:90-91) etj.

Në vazhdim po paraqesim temin e lëmit të grimit *ajlajner* (eye-liner), të cilën e përdorin shumica e nxënësve të shkollave të mesme të larta, e cila shënon një lloj lapsi për ngjyrosjen e vetullave dhe kapakëve të syve. Përdoret gjatë bisedave, kur flitet për grimin e nxënësve! Andaj në vend të këtij huazimi të përdoret togfjalëshi *laps vetullash*. Nga nxënësit shpesh përdoret togfjalëshi *boks meç* (boxing match), duke menduar se kanë drejtë, por duhet të përdoret togfjalëshi *ndeshje boks*, që i përshtatet natyrës së shqipes. Huazimi anglez *booking* (angl. booking) me kuptim të rezervimit të biletës për aeroplan, të rezervimit të dhomës në hotel duhet të zëvendësohet me “*rezervim*”.

Shtëpiza njëkatëshe apo përdhes *bungalou* (angl. bungalow) mund të zëvendësohet me fjalë shqipe *shtëpizë* apo *kasolle*. Termi *dragstor* (angl. drug store) shënon lokal in e barnatores, kurse shpesh përdoret në kuptimin shitore e madhe të artikujve ushqimorë. Sugjerojmë të përdoret termi-kompozitë *vetëshërbim*. Për pajisjen që rregullon ajrin në një dhomë, lokal apo ndërtesë përdoret termi *erkondishën* (angl. air-condition). Mirë do ishte të përdoret termi *ajërkondishën* ose kalku *rregullator klime* ose *ajërngrohës*. Anglicizmi *flert* (angl. flirt) përdoret shumë shpesh nga të rinjtë, që paraqet dashuri të rrejshme.

Andaj, sugjeroj të përdoret fjala shqipe *lajkë*. Fjala *hendikep* (angl. handicap) përdoret gjithashtu në shumë raste gjatë bisedave të nxënësve. Fjala shqipe *pengesë* e shpesh plotësisht kuptimin e fjalës angleze. Për rezervuarët e hedhurinave (bërllokut) shpesh përdoret termi *kontajner* (angl. container). Ky term mund të zëvendësohet me fjalën shqipe *arkë hedhurinash* ose *arkë bërlloku*. Kështu mund të japim këtu shumë terma tjerë, që përdoren nga nxënësit e shkollës së mesme teknike dhe profesionale (***inxhinieri, prodhimtari***), si: *absorbim* në vend *ndajthithj/e-ja*, *alezim-i* në vend *vrimezgjerim*, *alezator-i* në vend *vrimezgjeruesi-i*, *amortizator-i* në vend *fikatës-i*, *bajpas-i* në vend *anëkales/ë-a*, *argano-ja* në vend *çikrik-u*,

ashensor-i në vend hiptor-i, balancim-i në vend baraspeshim-i, koaksialitet në vend bashkaksi-a, bilancier-i në vend shilor-i, boiler-i në vend ujnëngrohës-i, korrodim-i në vend brejtj/e, bronzinë-a në vend nënkres/ë-a, limit në vend cak, pern-i në vend cekth-i, centrim-i në vend qendërzim-i, çift-i në vend par (angl. pair), dimension-i në vend përmas/ë-a, distributer-i në vend shpërndarës-i, diz/ë-a në vend hundëz-a, ekuilib/ë-ri në vend baraspeshë-a, erodim-i në vend gërryerj/e-a, ferod/ë-a në vend fërkojc/ë-a, fibë/r-a në vend fijëz-a, fonder-i në vend shkriticor/e-ja, sediment-i në vend fundërri-a, hidrant-i në vend gojues/e-ja, goniomet/ër-ri në vend këndmatës-i, gravitet-i në vend rëndes/ë-a, guarnicion-i në vend puthis/ë-a, ingranazh-i në vend rrotë dhëmbëzore, ingranim-i në vend ngërthim-i, invers-i në vend anasjell/ë-a, ekscentricitet-i në vend jashtëqendërsi-a, karburant-i në vendlëndë djegëse e lëngët, kardan-i në vend nyjtesë kardanike, kazan avulli në vend avullpërftor-i, koaksialitet-i në vendbashkaksi-a, komparator-i në vendkrahedor-i, koncentrator-i në vend përqëndrues-i, konsol-i në vendanëcak-u, konvejer-i në vend tejbartës-i, konveksitet-i në vendmysti-a, kopilje-a në vendbig/ël-a, korit/ë-a në vendgovat/ë-a, korrodim-i në vendbrejtj/e-, kremalier/ë-a në vend vizore dhëmbëzore, kuti e shpejtësisë në vend shpejtësindeërues-i, lubrifikant-i në vendlyrës-imadavid/ë-a në vendmatricë filetëprerëse, manovakummet/ër-ri në vendtrysnimatës-i, marmit/ë-a në vend zhurmëmytës-i, merkur-i në vend zhiv/ë-a, metal i zi në vendhekuror, metal me ngjyra në vend metal johekuror, elektromotor-i në vend motor elektrik, motorin/o-ja në vendelektrolëshor-i, normal/e-ja në vendpingul/e-ja, notues-i në vendpluskor-i, nxitim-i përshpejtim-i, parafang/o-ja në vend flat/ër-ra, parakolp-i në vend ndeshjepritis-i, pedal i gazit në vend pedal i përshpejtorit, përcjellës-i (elektrik) në vend përçuesi, plunxher-i në vend pistonçin/ë-a, planetar-i në vend rrotë dhëmbëzore planetare, inert-i në vend plogëti-a, pozicion-i në vend vend ndodhj/e-a, prixonier-i në vend bulon pa kokë, test-i në vend provë-a, punt/o-ja në vend shpojs/ë-a, radrizator-i në vend rrymëdrejtues-i, rekuoperator-i në vend rikthyyes-i, rigjenerim-i në vend rifitim-i, rimorki/o-ja në vend pasor/e-ja, riportabël-i në vend vendshkarkues/e-ja, plan-i në vend rrafsh-i, sforcim-i në vend ndemj/e-a, spidomet/ër-ri në vend shpejtësimatës-i, stampim-i në vend vulëzim-i, starter-i në vend lëshor-i, shiber-i në vend flag/ër-ra, van/ë-a në vend shliz/ë-a, shtypj/e-a (e gazit) në vend ngjeshj/e-a, impuls-i në vendshtys/ë-a, tegel saldimi në vendsaldur/ë-a, tension-inë vendndemj/e-a, tonazh-inë vend peshëbartj/e-a, torsiomet/ër-ri në vend përdredhjematës-i, transmetim-i në vendtejcim-i, transmision-i në vend tejçor-i, tranxh/ë-a në vend gërshërues/e-ja, brishtësi-a në vendthyeshmëri-a, unifikim-i në vendnjësim-i, vakummet/ër-ri në vend zbraztimatës-i, vat/ër-ra në vend zjarrtor/e-ja, vshje me bakër në vend bakërim-i, veshje me emal në vend emalim-i, veshje me krom në vendkromim-i, veshje me plumb në vendplumbim-i, vetëcentrim-i në vend vetëqendërzimi-i, volan-i në vend vrullan-i, xhunt/ë-a në vend bashkues-i, skori/e-a në vend zgjyr/ë-a, zhiv/ë-a në vend merkur-i, vibrator-i (vibrator) në vend dridhor-i, sens-i në vend kah-u (Pllana, 2022:351-357) etj.

Në lëndën e **edukatës fizike** kemi një zëvendësim të termave të huaj me barsvlerës në gjuhën shqipe, si: *bek-mbrojtës, refer-gjyqtar, trajnoj-stërvit, trajner-stërvitës, penalti-njëmbëdhjetëmetërsh, henc-goditje dënime, kornier-goditje nga këndi, aut-pozicion jashtë loje, kros-vrapim në natyrë, sprint-vrapim në largësi të shkurtër* etj.

Përfundim

Si përfundim, mund të themi se në këtë punim modest kemi bërë përpjekje për të gjetur ndonjë zgjidhje për fjalë-termat shqipe në vend të fjalëve të huazuara dhe të kalkuara, posaçërisht nga anglishtja. Krijimi i fjalë-termave dhe terminologjia tekniko-shkencore nuk është një grumbull fjalësh çfarëdo, por një sistem fjalësh-termash ose togfjalëshash terminologjikë të ndërtuar sipas normave të gjuhës dhe të lidhur në një mënyrë të caktuar ndërmjet tyre. Andaj, ky karakter sistemor i terminologjisë tekniko-shkencore përbën anën shkencore të saj.

Për krijimin e një sistemi vetjak (kombëtar) terminologjik është një punë profesionale krijuese, që kërkon kulturë dhe dije të gjerë, njohuri të thella të fushës përkatëse a të specialitetit, pra, njohjen e gjuhës dhe të artit (mjeshtërisë) së ndërtimit të termave të veçantë. Nevoja për krijimin e fjalë-termave varet nga zhvillimi i përgjithshëm i shkencës dhe teknikës dhe i kulturës, nga përparimet tekniko-teknologjike e nga rrethanat e caktuara historike të një vendi, si edhe nga ndryshimet e mëdha në gjirin e shoqërisë.

Përditësimi i fjalorëve të botuar, mënjanimi i termave të vjetruara si edhe hartimi i fjalorëve të rinj duhet të bëhen me kritere sipas të cilave si ndërkombëtarizma do të konsiderohen ato fjalë ose ata terma që janë të përbashkët në disa gjuhë jo farefisnore, kryesisht në anglisht ose në gjermanisht, në frëngjisht e në italisht. Një bashkëpunim i ngushtë në mes gjuhëtarëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme profesionale të ngushta, është mase i nevojshëm për krijimin e fjalë –termave të nevojshme për nevoja të nxënësve, studentëve, arsimtarëve dhe të gjithë atyre që përdorin mjete përdorim ditor dhe pajisje për prodhimtari të kohës.

Referencat

- [1]. Berani, Sh.: Birinxhiku, H.: *"Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj"* ETMM, Prishtinë, 1989.
- [2]. Breznica, P. A.; Pllana, S.: *"Mësimi i AQS-së (anglishtja për q137llime specifike) në SHMT "Lutfi Musiqi" në Vushtrri"*, Kërkime gjuhësore V Konferencë shkencore ndërkombëtare mbajtur më 15 korrik 2016, QSA IGJL, Tiranë, 2016, f. 433-442.
- [3]. Caka, N.; Dika, A.; Rodiqi, S.: *"Fjalor i informatikës anglisht-shqip shqip-anglisht"*, ASHAK Prishtinë, 2005.
- [4]. Çabej, E.: *"Studime gjuhësore III"*, Prishtinë, 1976, f. 101-1-2.
- [5]. Duro, A.; Vrapit, F.: *"Veçori të termave me burim nga anglishtja në gjuhën shqipe"*, në Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe probleme dhe detyra, Konferencë shkencore, ASHSH ASHAK, Tiranë, 2009, f. 197-211.
- [6]. Duro, A.: *"Studime gjuhësore (terminologji, gjuhësi kompjuterike, kritikë-bibliografi)"*, QSA IGJL, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012, f. 69-85.
- [7]. Duro, A.; Proko, V.: *"Shfaqje të thyerjes së standardit në terminologji"*, Konferencë shkencore ndërkombëtare UT FGJH, Tiranë 2023, f. 11-21.
- [8]. Dhrimo, A.; Memushaj, R.: *"Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe"*, INFBOTUES, Tiranë, 2011.
- [9]. Harizaj, M.: *"Roli dhe efikasiteti i ntë pyeturit si nxitës i ndërveprimit dhe aftësisht komunitativ të nxënësve të gjuhës së huaj"*, Kërkime gjuhësore IV Konferencë shkencore ndërkombëtare mbajtur më 10 korrik 2015, QSA IGJL, Tiranë, 2015, f. 609-611.
- [10]. Jahiu, E.: *"Njohja e fjalëve të huaja terminologjike e të përditshme nga të rinjtë: nvoj për përditësim fjalorësh"*, Konferencë shkencore ndërkombëtare UT FGJH, Tiranë 2023, f. 241-252.
- [11]. Kazmaj, N.: *"Probleme gjuhësore në të shkruarin e nxënësve"*, Kërkime gjuhësore IV, Konferencë shkencore ndërkombëtare mbajtur më 10 korrik 2015, QSA IGJL, Tiranë, 2015, f. 609-611.
- [12]. Kostallari, A.: *"Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka e saj"*, në "Sf", 4, Tiranë, 1984, f. 44-45.
- [13]. Lafe, E.: *"Leksiku trminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar"* në Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe probleme dhe detyra, Konferencë shkencore, ASHSH ASHAK, Tiranë, 2009, f. 53-62.
- [14]. Leka, F.: *"UDHËZUES për përpunimin e terminmologjisë tekniko-shkencore"*, ASHSH IGJL, Tiranë, 1983.
- [15]. Lloshi, Xh.: *"Shqipja gjuhë e hapur dinamike"*, ONUFRI, Tiranë, 2011, f.51-65.
- [16]. Memisha, V.: *"Studime për fjalën shqipe II"*, QSA IGJL, Tiranë, 2015, f. 39-46
- [17]. Memushaj, R.: *"Studime gjuhësore"*, ASA IGJL, Tiranë, 2017, f. 273-282.
- [18]. Nuhiu, V.: *"Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe"*, ASHAK, Libri 48, Prishtinë, 2013., f. 123-130.
- [19]. Pasho, H.: *"Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga RILINDJA deri në vitet '80 të shek. XX"*, Tiranë, 2005, f. 90-91).
- [20]. Pllana, G.; Pllana, S.: *"Fjalor terminologjik i teorisë së mekanizmave dhe të makinave (sistemor, me përkufizime dhe me tregues alfabetikë, të numërtuar në shqip, anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht)"*, Prishtinë, 2022, f. 351-357.
- [21]. Plangarica, T.: *"Aspekte të gjuhësisë së zbatuar 2"*, ASA IGJL, Tiranë, 2018, f. 111- 120.
- [22]. Skëndaj, A.: *"Leksiku terminologjik dhe përdorimi i tij për qëllime specifike"*, Konferencë shkencore ndërkombëtare UT FGJH, Tiranë 2023, f. 37-44.
- [23]. Shehu, H.: *"Fjalor angliht-shqip"*, EDFA, Tiranë, 2010.
- [24]. Shkurtaj, Gj.; Shopi, M.: *"Gjuha, ligjërimi dhe jeta"*, Tiranë, 2018, f. 16-24.
- [25]. Xhevor, M.: *"Frazologjizma të gjuhës shqipe"*, Rilindja, Prishtinë, 1972.